



Preshevë, 12/02/2026

**Kryeministri i Republikës së Kosovës
z. Albin Kurti**

Urime për mandatin e tretë në krye të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky është mandat i konsolidimit të sovranitetit, i thellimit të shtetndërtimit dhe i forcimit të rendit demokratik. Është mandat i punës, i integritetit dhe i qëndrueshmërisë përballë sfidave.

Për ne në Luginën e Preshevës, një Kosovë e fortë dhe e konsoliduar është mburoja jonë politike dhe kombëtare. Në një realitet të theksuar asimetrik në Serbi, ku të drejtat tona cenohen dhe diskriminimi institucional vazhdon, zëri dhe angazhimi i Republikës së Kosovës janë jetikë për afirmimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes sonë.

Ju falënderoj për mbështetjen dhe kontributin e vazhdueshëm gjatë dy mandateve të kaluara në fuqizimin e pozitës sonë dhe në ngritjen e çështjes së Luginës në nivel institucional e ndërkombëtar.

Forcimi i prezencës Tuaj kombëtare në Luginë, trajtimi i pozitës sonë në dialog dhe zbatimi i reciprocitetit si standard demokratik mbeten domosdoshmëri politike e kombëtare.

Besoj se ky mandat i tretë do të shënojë hap të rëndësishëm në shtetforcim brenda dhe në fuqizim të faktorit shqiptar jashtë kufijve të Kosovës.

Me respekt,

ARDITA SINANI

Kryetare e Komunës së Preshevës

